



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



***DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE
FINANCA***

***RREGULLORE
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNALE***

Mars, 2009

Në bazë të nenit 121 dhe 12.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 2.3 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e vetë të mbajtur me: **27.03.2009**, aprovon këtë:

RREGULLORE

PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 PËRKUFIZIMET

Me këtë rregullore caktohet lartësia e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime administrative komunale, që u sigurohen qytetarëve, personave fizikë dhe juridikë që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Komunës së Junikut.

Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji – termet dhe shprehjet në vijim – kurdo që përdoren në këtë ligj - kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë.

- **Taksë** - do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumentet, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialet e nevojshme.
- **Gjobë** - do të thotë një pagesë e cila duhet të bëhet në rast të shkeljes së një ligji, rregulle ose rregullore komunale. Në përgjithësi, gjobat shqiptohen me qëllim të dënimit të një shkelje dhe duhet të shqiptohen në përputhje me shumat fikse e cila paguhet në emër të shërbimit që ofrojnë organet komunale.
- **Viti fiskal**- do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ose “BKK”**- do të thotë buxheti gjithë përfshirës të Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore.
- **LMFPP**- nënkupton Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- **“KAMSH” ose “Korniza Afat Mesme e Shpenzimeve”**- ka kuptimin e përcaktuar në LMFPP.
- **Rregullore Komunale**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL –Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
- **Komuna**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.
- **Prona komunale**- nënkupton pronën, duke përfshirë pronën e paluajtshme, e cila është ligjërisht në pronësinë ose ligjërisht nën administrimin e komunës.
- **Të hyrat vetanake**- do të thotë të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna nga burimet e përcaktuara në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049.
- **Ndërmarrje** - do të thotë çdo organ, institucion, shoqatë, ndërmarrje, shoqëri tregtare, person juridik, ose organizatë tjetër.
- **Faturë tatimore** – do të thotë dokumenti i lëshuar nga Komuna tek tatimpaguesi që e njofton tatimpaguesin lidhur me detyrimin e tij tatimor për periudhën tatimore.

LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Neni 2

Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen do të caktohen me vendim të posaçëm nga Drejtoria përkatëse.

Neni 3

Lartësia e shumës për kërkesë për dhënien e certifikatës, deklaratës, vërtetimit, ushtrimin e veprimtarive në biznese, rentave, lejeve ndërtimore, kompensimeve për inspektime, gjobave dhe pagesa të tjera, përcaktohen me tarifa përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Tarifat e subjekteve caktohen sipas kësaj Rregulloreje, me aktvendime të Drejtorive sipas kërkesave të paraqitura.

Në mbështetje të kësaj Rregulloreje, neni 4, Drejtoritë përkatëse do të nxjerrin aktvendime për kategoritë lidhur me caktimin e taksave vjetore sipas llojit të veprimtarisë për biznese, si dhe për regjistrimin e transaksioneve të pronës, edhe në raste të tjera kur paraqitet nevoja.

Për ngarkesa të tjera obligimet llogariten dhe paguhen me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e subjekteve të ndryshme.

Neni 5

Subjektet, tarifën e caktuar në bazë të vendimit përkatës, do ta paguajnë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përfundimisht nga alineja 1. e këtij neni, ngarkesat e caktuara për operimin e firmave dhe të tatimit në pronën e qytetarëve dhe të personave juridikë, do të paguhen në 2 këste të barabarta dhe atë: Për subjekte afariste kësti i parë deri më 15 maj dhe kësti i dytë deri më 15 nëntor.

Për Tatimin mbi pronën, kësti i parë deri me 30 Qershor dhe kësti i dytë deri me 31 dhjetor të vitit tatimor.

Neni 6

Nëse obligimet e caktuara me vendim nuk paguhen brenda afatit të caktuar sipas Nenit paraprak, ndëshkimet do të aplikohen në bazë të Nenit 15 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Në rast të mos pagesës së taksës, Komuna do të veprojë sipas dispozitave ligjore, duke shfrytëzuar të drejtën e paraqitjes në gjykatën kompetente.

Neni 8

Drejtoritë përkatëse komunale për ngarkesat dhe pagesat sipas kësaj Rregulloreje, do të mbajnë evidenca në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 9

Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, në kuadër të autorizimeve të veta kujdesen drejtoritë përkatëse.

Nëse gjatë punës së tyre, Drejtoritë hasin në parregullsi, do të bëjnë përpjekje për t'i evituar ato dhe do të bëjnë propozime përkatëse për eliminimin e këtyre parregullsive. Këto punë, Drejtoritë do t'i kryejnë përmes personave zyrtarë.

Neni 10

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas Rregullores komunale në llogaritë përkatëse të Komunës drejtpërsëdrejti në arkë deri në 10 € ndërsa përmes bankave afariste në shumën mbi 10 €.

II. ANKESAT DHE MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 11

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga Komuna, nëse ai ose ajo deklaron se i janë shkelur të drejtat e tij.

Neni 12

Ndaj vendimit përfundimtar të Komunës mund të ushtrohet ankesë Komisionit për shqyrtimin e ankesave nga taksat ngarkesat e gjobat të Ministrisë së Ekonomisë e Financave dhe Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 13

Të gjitha subjektet ekonomike, shfrytëzuesit e hapësirave publike dhe personat tjerë, të cilët sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë obligues të ngarkesave të parapara, obligohen që në afatin brenda 15 ditësh nga dita e publikimit të kësaj Rregulloreje të bëjnë paraqitjen e obligimeve të tyre.

Kërkesën për lejen e punës nëse me leje nuk disponon të bëjë kërkesën për marrjen e lejes për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe të paraqes akte të tjera në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 14

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje për 15 ditët vijuese nuk do të aplikohen masat ndëshkuese.

Neni 15

Nëse personi nuk e përmbush obligimin gjatë afatit të caktuar me vendim, interesi prej 20 % për vit do të jetë i aplikueshëm për biznese dhe 15% për persona fizik. Sidoqoftë, shuma totale nuk do të tejkalojë 100% të taksës së aplikuar.

Neni 16

Personat juridikë apo fizikë, të cilët gjatë punëve ndërtimore i kanë dëmtuar rrugët apo hapësirat tjera publike, janë të obliguar të evitojnë dëmin e shkaktuar në afat brenda 5 ditësh e nëse këtë nuk e bëjnë, gjobiten në shumën sipas dëmit të shkaktuar.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE E FUNDIT

Neni 17

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është pasqyra tabelore e tarifave dhe ngarkesave të shprehura në EURO.

Neni 18

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon aplikimi i Rregullores mbi Caktimin e Lartësisë së Taksave dhe Ngarkesave për Shërbimet Komunale datës 26.03.2008, lidhur me taksat dhe ngarkesat komunale që kanë qenë në fuqi deri më tani.

Neni 19

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje duhet të bëhen në mënyrë analoge sikurse edhe vet Rregullorja e taksave ngarkesave dhe gjobave të Komunës së Junikut.

Neni 20

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga komisioni për certifikimin e rregulloreve nga MEF dhe MAPL ne pajtim me UA nr. 2007/2 dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Junikut.

PASQYRA TABELORE E TARIFAVE DHE NGARKESAVE TË

SHPREHURA NË EURO

1. TARIFAT E NDRYSHME PËR DHËNIEN E DOKUMENTIT ZYRTAR

1.1.1	Certifikatë e lindjes	1,00 €
1.1.2	Certifikatë e martesës	1,00 €
1.1.3	Certifikatë e vdekjes	1,00 €
1.1.4	Certifikatë e shtetësisë	1,00 €
1.1.5	Certifikatë e statutit martesor/pa dëshmitar	2,00 €
1.1.6	Certifikatë e statutit martesor/me dëshmitar	5,00 €
1.1.7	Certifikatë mbi vendbanimin, jetën	2,00 €
1.1.8	Aktivdekje	2,00 €
1.1.9	Deklaratë mbi bashkësinë familjare	2,00 €
1.1.10	Regjistrimet dhe përshkrimet në LAM, LAV	1,00 €
1.1.11	Procedura e lidhjes së martesës	8,00 €
1.1.12	Procedura e martesës jashtë orarit të punës dhe jashtë objektit komunal	35,00 €

1.2. NGARKESAT E NDRYSHME

1.2.1	Deklarata me dy dëshmitarë	2.00 €
1.2.2	Vërtetim i fotokopjeve, saktësimi i dokumenteve origjinale (1 faqe)	1.00 €
1.2.3	Legalizimi i përmbajtjes së dokumentit , dorëshkrimeve, nënshkrimeve	2,00 €
1.2.4	Vërtetim për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës	2.00 €
1.2.5	Vërtetim mbi mjetet për jetesë - mbajtje	5,00 €
1.2.6	Vërtetimet tjera	2,00 €
1.2.7	Kërkesat tjera	1,00 €

1.3. AKTVENDIMET E NDRYSHME

1.3.1	Ndërrimi – korrigjimi - gërmisim i emrit dhe mbiemrit personal	3,00 €
1.3.2	Lejim regjistrime të më vonshme në LAL, LAV	3,00 €
1.3.3	Intervenimet tjera të lejuara në LAL, LAV DHE LAM në pajtim me ligjin mbi librat amëz	3,00 €

Vërejtje: Tarifat paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës. Pa dëshmi mbi pagesën e tarifës nuk mund të dorëzohet dokumenti i kërkuar.

1.4.. TARIFAT KOMUNALE VJETORE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARIVE NË BIZNES

Caktohet taksa vjetore sipas llojit të veprimtarisë

1.4.1.	Veprimtari Prodhuese	
1.4.1.1.	Prodhuesit e energjisë elektrike	400.00 €
1.4.1.2.	Kompanitë shoqërore dhe publike	200.00€
1.4.1.3.	Gurëthyesit	200.00 €
1.4.1.4.	Ndërmarrjet Ndërtimore	200.00€
1.4.2.	Veprimtarit përpunuese	
1.4.2.1.	Përpunuesit e prodhimeve të mishit dhe thertoret	200.00€

1.4.2.2.	Përpunuesit e Qumështit	50.00€
1.4.2.3.	Përpunuesit e elementeve plastikes, aluminit	200.00€
1.4.2.4.	Metalpunuesit	70.00€
1.4.2.5.	Punuesit e gurëve te Varrezave	80.00€
1.4.3.	Veprimtari Bankiere, Lojëra fati e te ngjashme	
1.4.3.1.	Banka ekspozitura	250.00€
1.4.3.2.	Këmbimoret	150.00€
1.4.3.3.	Kompanitë e sigurimeve	250.00€
1.4.3.4.	Bingot, Bastoret, lojërat e fatit	150.00€
1.4.4.	Agjencionet	
1.4.4.1.	Agjencionet e sigurimeve te automjeteve	100.00€
1.4.4.2.	Agjencionet turistike (autobusët)	150.00€
1.4.4.3.	Agjencionet për transfere të parave	150.00€
1.4.5.	Veprimtarit tregtare	
1.4.5.1.	Pompat e benzinës	200.00€
1.4.5.2.	Shitore ushqimore	70 .00€
1.4.5.3.	Shitore tekstili	80.00€
1.4.5.4.	Supermarketet dhe Vetëshërbimet	200.00€
1.4.5.5.	Shitore e teknikes se bardh	100.00€
1.4.5.6.	Automekanik	100.00€
1.4.5.7.	Shitore e autopjesëve	100.00€
1.4.5.8.	Shitore e lëkur këpucëve	80.00€
1.4.5.9.	Shitore e mobileve dhe tepihëve	200.00€
1.4.5.10.	Shitore e teknikës informative	100.00€
1.4.5.11.	Shitore e ngjyrës dhe llaqeve	100.00€
1.4.5.12.	Ëmbëltoret	80.00€
1.4.5.13.	Podrum (depot e pijeve)	80.00€
1.4.5.14.	Depot e materialit ndërtimor	200.00€
1.4.5.15.	Librarit	80.00€
1.4.5.16.	Shitoret optike,kozmetik,bizhuteritë, videoklubet	80.00€
1.4.5.17.	Barnatoret bujqësore dhe shëndetësore	50.00€
1.4.5.18.	Tregtare lëvizëse	30.00€
1.4.5.19.	Kiosqet	20.00€
1.4.6.	Shërbimet hoteliere dhe ushqimore	
1.4.6.1.	Hotelet	250.00€
1.4.6.2.	Motelet	200.00€
1.4.6.3.	Restorantet	150.00€
1.4.6.4.	Kafiteritë	100.00€
1.4.6.5.	Mishtore	100.00€
1.4.6.6.	Bukëpjekësit	100.00€
1.4.6.7.	Gjellëtore, Qebaptore	100.00€
1.4.6.8.	Piceritë	100.00€
1.4.7.	Veprimtari zejtare	
1.4.7.1.	Autolarësit	50.00€
1.4.7.2.	Zdrukthëtarit	140.00€
1.4.7.3.	Autoserviset, autoelektracistet, elektroservisimet	80.00€
1.4.7.4.	Fotografet	80.00€

1.4.7.5.	Frizerët	50.00€
1.4.7.6.	Moler- gipser	150.00€
1.4.7.7.	Punuesit e mbishkrimeve te firmave	50.00€
1.4.7.8.	Instaluesit e ujit, rrymës	50.00€
1.4.8.	Veprimtari profesionale	
1.4.8.1.	Avokat	150.00€
1.4.8.2.	Laboratorë, ordinancat mjekësore	150.00€
1.4.8.3.	Byrotë projektuese	100.00€
1.4.8.4.	Shërbimet financiare dhe kontabilitetit	80.00€
1.4.8.5.	Shërbimet veterinare	80.00€
1.4.8.6.	Shkollat private	100.00€
1.4.9.	Veprimtari tjera shërbyese	
1.4.9.1.	PTK	250.00€
1.4.9.2.	KEK	250.00€
1.4.9.3.	Ndërmarrjet e taxive dhe auto shkollat	150.00€
1.4.9.4.	Vend parkingjet	80.00€
1.4.9.5.	Internetet	80.00€
1.4.9.6.	Auto-taxi transportus (fugon)	100.00€
1.4.9.7.	Auto-taxi pasagjer	50.00€
1.4.9.8.	Ekskavatorët	150.00€
1.4.9.9.	Basenet	100.00€
1.4.9.10.	Fushat sportive te mbyllura	150.00€
1.4.9.11.	Fushat sportive te hapura	90.00€
1.4.9.12.	Fidanishtet	50.00€
1.4.9.13.	Tv	150.00€
1.4.9.14.	Radiot	100.00€

Vërejtje: Nëse regjistrimi i subjektit afarist bëhet në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik paguhet ngarkesa për tërë vitin 100%. Nëse regjistrimi i subjektit afarist bëhet në gjashtëmujorin e dytë ngarkesa për atë vit bëhet 50 % nga tarifa bazë. Bizneset me orar të shkurtuar paguajnë 50 % të tarifës vjetore.

Bizneset të cilat nuk punojnë janë të liruar nga tarifa por për këtë paraprakisht ta njoftojnë Drejtorin për Ekonomi dhe Financa.

Bizneset në zonat rurale (zona e III- IV) tarifa është 50% më e ulët se tarifa bazë.

Bizneset qe operojnë ne zonën e II paguajnë 20% më ulët se tarifa bazë.

Bizneset të cilat merren me veprimtari bujqësore me karakter prodhues lirohen për 50 % nga tarifa bazë.

Te gjitha bizneset afariste të cilat veprojnë në Komunën tonë dhe selinë e kanë jashtë territorit të Komunës së Junikut do të paguajnë 80% nga tarifa bazë .

Pagesa mund të bëhet me 3 këste (15 prill , 15 korrik dhe 15 tetor)

Për mos kryerjen e obligimit me kohë merren masa ndëshkuese me kamatë mujore prej 1%.

1.4.10. Tarifat në sferën e Shëndetësisë dhe Çështje Sociale:

Nr. i tarifës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjobat	Vlera €
Shërbimet shëndetësore të nivelit parësor		
1.4.10.1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostiko me aparaturë	1.00
1.4.10.2.	Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF pa udhëzim të mjekut familjes	2.00
1.4.10.3.	Ekzaminimi specialistik në QMF QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4.00
1.4.10.4.	Ekzaminimi në shtëpi përpos në rastet emergjente	6.00
1.4.10.5.	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike	0.30
1.4.10.6.	Ultrazëri	2.00
1.4.10.7.	Radiografia	2.00
1.4.10.8.	EKG	0.50
1.4.10.9.	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
1.4.10.10.	Analizat laboratorike (komplet)	3.00
1.4.10.11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
1.4.10.12.	Audio grami	1.00
1.4.10.13.	Shpërlarja e veshit	1.00
1.4.10.14.	Dhënia e injeksionit intermuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
1.4.10.15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
1.4.10.16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
1.4.10.17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
1.4.10.18.	Certifikata e vozitje e lëshuar nga konzuliumi profesionist	18.00
1.4.10.19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00
1.4.10.20.	Dhënia e raportit mjekësor – vërtetimit ose dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
1.4.10.21.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktivitetit sportiv etj për një orë	25.00
1.4.10.22.	Vizita e parë stomatologjike	1.50
1.4.10.23.	Nxjerrja e dhëmbit	3.00
1.4.10.24.	Rtg e dhëmbit	1.50
1.4.10.25.	Rtg ortopantomogrami	3.75
1.4.10.26.	Mbushja definitive me amallgam	7.00
1.4.10.27.	Mbushja definitive me kompozitë (estetike)	7.00

1.4.10.28.	Shërimi me mbushje definitive	7.00
1.4.10.29.	Extirpimi vital apo mortal me mbushje definitive	9.00
1.4.10.30.	Shërimi i kanalit me mbushje definitive	11.25
1.4.10.31.	Heqja e gurzive me ultratingull	5.00
1.4.10.32.	Kiretazha e gjepave paradontal	5.00
1.4.10.33.	Proteza parciale dhe totale	40.00
1.4.10.34.	Rindërtimi	3.75
1.4.10.35.	Kurora me rezine (isosit)	15.00
1.4.10.36.	Kurora e porcelanit	45.00
1.4.10.37.	Heqja e kurorës se vjetër apo te përkohshme	3.00
1.4.10.38.	Proteza totale apo parciale nga rezina	30.00
1.4.10.39.	Zëvendësimi i dhëmbit të humbur në protezë	6.00
1.4.10.40.	Riparimi i thyerjes se protezës	3.00
1.4.10.41.	Protezë parciale metalike e skeletuar	37.75
1.4.11. Tarifat dhe ngarkesa tjera /Inspekcioni		
1.4.11.1.	Mos pajisja me librezë sanitare që kanë të bëjnë me ushqimin dhe pijet si shërbime ofrimi, përpunimi apo servili.	25.00
1.4.11.2.	Për mos mbajtje të higjienës personale (duar të pa pastërta thonj të pa prerë dhe higjienë tjetër personale)	15.00
1.4.11.3.	Mosndërmarrja e veprimit profilaktik të DDD-së për të gjitha subjektet që merren me shërbime të ofrimit të ushqimit të përpunuar dhe të shitjes njëherë në gjashtë muaj	70.00
1.4.11.4.	Mosndërmarrja e veprimit profilaktik të DDD-së për të gjitha subjektet publike dhe private edukativo arsimore dhe shëndetësore një herë në vit	70.00
1.4.11.5.	Për mos higjienë në bllokun sanitarë WC, mos pajisja me detergjente për pastërti dhe mjete tjera ndihmëse, ajrimi apo ventilimi	25.00
1.4.11.6.	Për mos mirëmbajtje të higjienës në ambientin e punës	40.00
Për ekspozim te mallrave ushqimore dhe pijeve(të produkteve dhe nën produkteve ushqimore dhe industriale në ambientet klimatike dhe mikroklimatike qe janë në kundërshtim me kushtet e ruajtjes dhe shitjes (jo adekuate higjienike) ne treg ,apo ne kundërshtim me kushtet e dhëna nga deklaracioni i prodhuesit		
1.4.12.1	Për persona juridik	50.00
1.4.12.2.	Personi fizik	20.00
Konfiskimi i të gjitha mallrave (artikujve) me afat të skaduar ushqimore, pijeve dhe produkteve tjera si: medicinave, kozmetike etj		
1.4.13.1.	Lëshimi i vërtetimit për konfiskim ,izolim apo dhe shkatërrim malli ushqimor dhe te pijeve në peshë prej; 5kg 100 kg	30.00
1.4.13.2.	Në peshë prej;100 kg e më shumë	70.00
1.4.13.3.	Lëshimi i vërtetimit, për izolim, konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimorë dhe produkte tjera farmaceutike , kozmetike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit prej 5 kg deri në 100 kg	50.00

1.4.13.4.	Lëshimi i vërtetimit, për izolim, konfiskim dhe shkatërrim malli ushqimorë dhe produkte tjera farmaceutike, kozmetike në varësi nga sasia e mallit dhe vlerës së regjistruar duke pasur parasysh sasinë e mallit mbi 100 kg	100.00
1.4.13.5.	Lëshimi i vërtetimit për izolim të mallit apo shkatërrim me kërkesë të palës do të bëhet varësisht nga sasia e mallit të regjistruar duke pasur parasysh tarifat 5.11 dhe 5.12 më lirë.	50%
Marrja e mostrës dhe hulumtimi i artikujve ushqimor dhe pijeve		
1.4.14.6.	Nga ana e inspektorit sanitar në bazë të kushteve të dyshimta të artikullit apo pijeve ushqimore në subjektin afarist tregtar ushqimor shërbyes etj marrja e kësaj mostre në atë subjekt do të bien barrë shpenzimi i një mostre në vlerë	30.00
Në rast të helmimit me artikuj ushqimor, intoksikacionit dhe toksiiinfeksionit me ushqim të dyshuar në subjektet e ofrimit të shërbimeve me artikuj ushqimor dhe pijeve etj dhe vërtetimi mjekësor i gjendjes së personit të helmuar do të pasojë masa të gjobës		
1.4.15.1.	Shpenzimet e mostrimit dhe shërbimet e tjera do t'i bart subjekti në fjalë	100.00
1.4.15.2.	Në rast të rezultateve pozitive nga institucionet shëndetësore mbi infeksionin apo helmimin e klientit nga subjekti afarist tregtar apo shërbyes me artikuj ushqimor pije etj masa e gjobës do të jetë	300.00
1.4.15.3.	Ankesa e qytetarit drejtuar inspeksionit sanitar për produktin ushqimor jo higjienik-shëndetësor, në rast të verifikimit nga ana e inspektorit sanitar dhe vërtetimit në subjektin afarist të atij artikulli ushqimor gjoba do të jetë,	50.00

Në rastin e mos përmbushjes së cilës do tarife të parapara sipas pikës 1.4.10. të kësaj rregulloreje do të merren masat si në vijim:

1. Personit juridik do t'i rritet gjoba e caktuar,.....100%
2. Personit fizik do t'i rritet gjoba e caktuar,.....50%

2. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Subjektet afariste që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për inspeksionin e tregut Ligji Nr. 02/L-1, Ligjin për tregtinë e brendshme Ligji Nr. 2004/18, Ligjin për zeytari Ligji Nr. 2004/44, Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve Ligji Nr. 2004/17, Ligjin për veprimtarit hoteliere dhe turistike Ligji Nr. 2004/16 apo dispozitat të cilat nxirren nga këto Ligje, inspektoret komunal mund të shqiptojnë gjoba bazuar në dispozitat ndëshkuese të këtyre Ligjeve në fuqi.

2.1. TARIFA NË TRANSAKSION TË PRONËS PËR PARCELË (NJËSI BLERËSE)

2.1.1	Për parcelë-njësi	100.00 €
2.1.2	Për transakcion të bizneseve	100.00 €

Vërejtje: Transaksionet, të cilat bëhen në trashëgimi dhe dhurata në rendin e parë të trashëgimisë zbatohet UA Nr. 2006/ 1 i AKK-së, neni 6 i këtij UA. Pa dëshmi mbi pagesën e taksës, sipas kësaj tarife nuk mund të bëhet bartja e ndryshimeve në librat e drejtorisë përkatëse. Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës

3. NGARKESAT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PRONËS KOMUNALE MBI SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË TOKËS

3.1. Toka me shfrytëzim të përkohshëm pa ndërtime plotësuese për kultivimin e kulturave bujqësore caktohet:

Tarifa vjetore	150.00 € /ha
----------------	--------------

3.1.1. Tokat me shfrytëzim të përkohshëm me ndërtime të objekteve për qëllim të bizneseve prodhuese caktohet:

Tarifa vjetore	0.02 € m ²
----------------	-----------------------

3.1.2. Tokat me shfrytëzim të përkohshëm me ndërtime të objekteve për qëllim të bizneseve komerciale caktohet:

Tarifa për Zonën e I-rë:	0.04 € / m ²
Tarifa për Zonën e II-të:	0.03 € / m ²
Tarifa për Zonën e III-të:	0.02 € / m ²
Tarifa për Zonën e IV-të:	0.01 € / m ²

4. NGARKESAT NGA PRONA PËR SHFRYTËZIM AFAT SHKURTËR

4.1.1.	Objektet (zyra) në prone komunale tarifa mujore	4.00 € m ²
4.1.2.	Lokalet (afariste) në prone të komunës tarifa mujore	4.00 € m ²

5. NGARKESAT PËR SHFRYTËZIMIN E SIPËRFAQEVE PUBLIKE, DETYRIMI BAZË ËSHTË PËR SHFRYTËZIMIN E m², SIPAS ZONAVE TË QYTETIT

5.1. Vendosja e qoshqeve (kiosqeve) dhe objekteve të tjera prej montazhi, në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hoteleri), tarifa mujore sipas zonave:

Zona e I-rë	tarifa	4.00 € / m ²
Zona e II-të	tarifa	3.00 € / m ²
Zona e III-të	tarifa	2.00 € / m ²
Zona e IV-të	tarifa	2.00 € / m ²

5.2. Vendosja e pajimeve për akullore dhe pajimeve të ngjashme: Tarifa mujore sipas zonave:

Zona e I-rë	tarifa	4.00 €
-------------	--------	--------

Zona e II-të	tarifa	3.00 €
Zona e III-të	tarifa	2.00 €
Zona e IV-të	tarifa	2.00 €

5.3. Vendorsja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollorë, caktohet tarifa mujore sipas zonave :

Zona e I-rë	tarifa	4.00 €
Zona e II-të	tarifa	3.00 €
Zona e III-të	tarifa	2.00 €
Zona e IV-të	tarifa	2.00 €

5.4. Shfrytëzimi i hapësirës para objektit, në të cilën kryhet veprimtaria tregtare tarifa mujore sipas zonave

Zona e I-rë	tarifa	2.00 € / m ²
Zona e II-të	tarifa	1.00 € / m ²
Zona e III-të	tarifa	0.50 € / m ²
Zona e IV-të	tarifa	0.25 € / m ²

5.5. Shfrytëzimi i hapësirës para objektit në të cilën kryhen shërbime hoteliere tarifa vjetore sipas zonave:

Zona e I-rë	tarifa	5.00 € / m ²
Zona e II-të	tarifa	4.00 € / m ²
Zona e III-të	tarifa	3.00 € / m ²
Zona e IV-të	tarifa	2.00 € / m ²

5.6. Për shfrytëzime të tjera të hapësirës publike, ekspozimi i mallit, ambalazhi caktohet tarifa vjetore sipas zonave:

Zona e I-rë	tarifa	10.00 € / m ²
Zona e II-të	tarifa	8.00 € / m ²
Zona e III-të	tarifa	5.00 € / m ²
Zona e IV-të	tarifa	3.00 € / m ²

6. EKSPOZIMI PUBLIK I VITRINAVE REKLAMUESE

Sipërfaqe ekspozuese e vitrinës, konsiderohet sipërfaqe në të cilën janë të ekspozuara gjërat reklamuese. Ngarkesa paguhet për metër katror të sipërfaqes së dukshme ku ekspozohet reklamimi.

Vendorsja e vitrinave për ekspozimin e mallit jashtë lokalit afarist tarifa mujore sipas zonave.

Zona e I-rë	tarifa	10.00 € / m ²
-------------	--------	--------------------------

Zona e II-të	tarifa	8.00 € / m ²
Zona e III-të	tarifa	5.00 € / m ²
Zona e IV-të	tarifa	3.00 € / m ²

Vërejtje: Ngarkesat sipas këtyre tarifave paguhen me rastin e marrjes së Lejes për vendosje për të cilat merret pëlqimi nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, si dhe të bëhet kontrata përmes Kryetarit dhe kompanive .

Me zona nënkuptohet:

6.1. Zona e parë

Përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale, ku përfshin rrugën nga Qendra e Junikut e deri te ura e shkollës fillore, rruga nga Qendra e Junikut deri te rruga e mullirit të Çokut, rruga nga Qendra e Junikut e deri te stacioni policor, rruga nga Qendra e Junikut (rruga për Dobrosh) e deri te udhëkryqi i rrugës së Berishës dhe rruga nga Qendra e Junikut e deri te Ura e Erenikut.

6.2. Zona e dytë

Përfshinë hapësirën në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale pas përfundimit të zonës së parë sipas nenit 3.1. dhe përfshin: rruga nga shkolla deri në Voksh, nga rruga e mullirit të Çokut deri në Rastavicë, nga rruga e udhëkryqit të Berishës deri në Dobrosh, dhe rruga nga ura e Erenikut deri në Batushë dhe objektet tjera të banimit në lagjet: Gacafer, Pepsh, Bajraktar, Hoxhë, Berishë, Miroc, Krasniqi, Gaxherr i ulët dhe i Epërm, Shalë, Malok, dhe Qestaj.

6.3. Zona e tretë

Përfshinë të gjitha hapësirat te cilat nuk janë të përfshira në zonën e I- rë dhe të II - të, e që i përkasin Qytetit të Junikut: lagja Goçaj dhe lagja Agim Ramadani - e cila dallon nga zona industriale dhe objektet tjera të banimit të cilat gjinden në periferi të lagjeve të cekura në zonën e dytë.

6.4. Zona e katërt përfshinë:

Te gjitha hapësirat j ashtë Qytezës së Junikut: fshatrat Gjocaj dhe Jasiq.

Zona Rurale Përfshin të gjitha hapësirat jashtë Qytezës së Junikut

7. EKSPOZIMI I PANOVE REKLAMUESE

Sipërfaqja eksponuse e panove reklamuese konsiderohet sipërfaqja në të cilën janë të ekspozuara reklamat për biznes etj. Në qytet, apo jashtë qytetit dhe bri rrugës kryesore. Pagesa bëhet për metër katror të sipërfaqes së dukshme nga rruga.

7.1. EKSPOZIMI I PANOVE REKLAMUESE NË QYTET

Tarifa Vjetore	50.00 € / m ²
----------------	--------------------------

Panotë reklamuese me ndriçim paguhen me tarifë të shtuar për 30 %, ndërsa reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është e ndaluar.

7.2. EKSPOZIMI I PANOVE REKLAMUESE JASHTË QYTETIT.

Tarifa Vjetore	20.00 €/ m ²
----------------	-------------------------

Ngarkesat sipas kësaj tarife paguhen me rastin e marrjes së lejes për vendosjen e panove reklamuese nga Drejtoria përkatëse, për aq kohë sa do të jenë të vendosura panotë (pllakatet).

Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak se 30 ditë, shtohet vlera për 50 %.

Nëse pllakati është shumëkrahëshe, paguhet për çdo krah të dukshëm.

Organizatrat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare, nuk ngarkohen me tarifrat e theksuara më lartë.

7.3. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lodrave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave të tjera sportive, paguhet ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit.

7.4. Për mbajtjen e aparateve për lojëra fati që sjellin fitim në para:

Tarifa mujore	5.00 €
---------------	--------

7.5. Për mbajtjen e aparateve për lojëra argëtuese etj.

Tarifa mujore	5.00 €
---------------	--------

7.6. Për tavolinë të bilardos:

Tarifa mujore	10.00 €
---------------	---------

7.7. Ngarkesa nga toka për shfrytëzim afat shkurtër kampingje, lojëra etj

Tarifa ditore	0.10 €/ m ²
---------------	------------------------

Vërejtje: Tarifa, sipas pikave të theksuara në këtë tarifë paguhen me rastin e dhënës së lejes nga drejtoria përkatëse.

8. TARIFAT INSPEKTUESE

8.1. Inspektimi veterinar për kafshë të trasha, si p.sh. lopët, kuajt etj:

Tarifa	5.00 €
--------	--------

8.2. Inspektimi veterinar për kafshë të imta, si p.sh. delet, dhitë, qentë, macet etj.

Tarifa	1.00 €
--------	--------

8.3. Vërtetim i lëshuar për kafshë të imëta nga stacioni i veterinarit.

Tarifa	1.00 €
--------	--------

8.4 Nga mjetet e mbledhura nga pika 6.1.1 dhe 6.1.2 veterinës i takojnë 50 %.

9. PRANIMI TEKNIK I LOKALEVE AFARISTE

Tarifa për lokalin deri më 30 m ²	30.00 €
Tarifa për çdo m ² më tepër	0.50 €
Tarifa për dhënien e pëlqimit për plotësimin e kushteve higjeniko-sanitare	5.00 €
Tarifa për dhënien e pëlqimit për mbrojtje kundër zjarrit	5.00 €

Vërejtje: Kjo tarifë aplikohet pasi subjekti kërkues paraqet dëshminë si: certifikatën e Biznesit të lëshuar nga MTI ,fletën poseduese apo kontratën me qira ,dëshminë e arsimit përkatës (diplomat, certifikatat etj.)

9.1. INSPEKTIMI PËR MBROJTJEN E KUSHTEVE HIGJENIKO-SANITARE

Tarifat për inspektim nga inspeksion sanitar	5.00 €
--	--------

9.2. INSPEKTIMI I MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT

Tarifa për inspektim nga mbrojtja kundër zjarrit	5.00 €
--	--------

Vërejtje: Të gjitha këto ngarkesa paguhen me rastin e inspektimit nga inspektorët komunal më rastin kur pala merr procesverbalin.

9.3. NGARKESA PËR SHKATËRRIMIN E NDËRTIMIT TË PAAUTORIZUAR.

Tarifa	13.00 €/m ²
--------	------------------------

9.4.Ngarkesa për rregullimin e pronës pas shkatërrimit të ndërtimit të paautorizuar.

Tarifa	8.00 €/m ²
--------	-----------------------

Vërejtje: Nëse shpenzimet e shkatërrimit nga pika 8.1 dhe 8.1.1 janë më të mëdha, atëherë duhet të formohet komisioni për kalkulimin mbi shpenzimet e shkatërrimit. Shpenzimet e shkatërrimit bien barrë e investitorit, i cili nuk ka pasur leje për ndërtim nga drejtoria e autorizuar komunale.

9.5. SHNDËRRIMI I TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE (JOBUIJQËSORE)

Tarifa për klasën e 1 deri 4	1.00 €/m ²
Tarifa për klasën e 5 dhe 6	0.75 €/m ²
Tarifa për klasën e 7 dhe 8	0.50 €/m ²

Vërejtje: Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore do të jetë tarifa 20% nga tarifat e destinimit të përhershëm .

Kompetenca për marrjen e vendimit në ndërrimin e tokës bujqësore prej klasës së 1 deri 4 do të bëhet me Vendim të Kuvendit Komunal pas marrjes së pëlqimit nga Ministria. Për klasën e 5 dhe 6 shndërrimi bëhet në bashkëpunim me bujqësinë dhe planifikimin, ndërsa për klasën e 7 dhe 8 përgjegjës është organi për bujqësi.

10. TARIFAT NË SFERËN E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Nr. i tarifës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjobat	Vlera €			
Kërkesat					
10.1.1.	Kërkesa për kushte të lokacionit-ekstraktit nga plani, për Parcelim-kompletim të 1 trualli urbanistik; për pëlqim urbanistik, leje urbanistike, për dhënien e pëlqimit dhe kushteve të lokacionit jashtë PRR U dhe jashtë planit ZhU, për ndryshim - plotësim të PDU me shikim në vend të ngjarjes, për leje urbanistike, për dhënien e pëlqimit- për vendosjen e objekteve të karakterit të përkohshëm të tipit montues, për caktimin e vijës së ndërtimit dhe vijës së rregullimit të truallit ndërtimor e të ngjashme	10,00			
10.1.2.	Kërkesa për Leje Ndërtimi	10.00			
10.1.3.	Kërkesa për Kontrollim Teknik dhe lëshimin e Lejes së Përdorimit-shfrytëzimit të objektit	10.00			
10.1.4.	Komisioni për vlerësimin e amortizimit-vjetërsisë, satbilitetit, funksionalitetit etj të objektit.	10,00			
10.1.5.	Kërkesa për dhënjen e pëlqimit për mirëmbajtje vijuese dhe investive të objektit.	10.00			
10.1.6.	Kërkesa për Rrënimin-demolimin - largimi i objekteve	10,00			
